

PSH.nr.637/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje individuale të Nuhi Paçarizi – panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “N.N.SH. Emsa” - Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Mazreku & AAB Construction” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kiosqeve në sheshin “Adem Jashari”, me nr. të prok: 644-20-771-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri, më datë: 25.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik “N.N.SH. Emsa” – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kiosqeve në sheshin “Adem Jashari”, me nr. të prok: 644-20-771-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kiosqeve në sheshin “Adem Jashari”, me nr. të prok: 644-20-771-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues ekonomik “N.N.SH. Emsa” - Suharekë, refuzohet si e pabazuar, të njëjtit operator ekonomik i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “N.N.SH. Emsa” - Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 07.09.2020 me nr. 637/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kiosqeve në sheshin “Adem Jashari”, me nr. të prok: 644-20-771-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59, 60 dhe nenin 105 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 09.09.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 18.09.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Fillimisht sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP, palët janë të njëjta, ankesa është e përsëritur nga OE i njëjtë. Edhe atëherë ishte kontestuar kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, kundrejt projekteve të realizuara. Potencohej se OE edhe tani i propozuar për dhënie nuk ka prezantuar projekte sipas kërkesës së AK-së.

Ne i kemi trajtuar pretendimet, po ashtu kemi dhënë propozimin tonë, megjithatë Paneli Shqyrtues përmes vendimit me nr. 399/20, të datës 27.07.2020, kishte anuluar njoftimin për dhënie të kontratës, duke obliguar AK-në që: “...gjatë ri-vlerësimit të tenderëve të vërtetoj se a janë kontratat e ngjashme apo a ka pozicione të njëjta në kontratat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë komform kërkesave të dosjes së tenderit”. Autoriteti Kontraktues/ Komuna Vushtrri përgjatë ri-vlerësimit të ofertave, përkatësisht me datën 18.08.2020, përveç OE-ve tjerë i drejtohet edhe OE tani të ri-rekomanduar për dhënie, me kërkesën kryesore, që të prezantohen dëshmitë, përkatësisht para masat e projekteve, të përshkruar në letrën standarde, kërkesën për sqarim dhe informata shtesë, të cilën si provë do ja bashkëngjisim këtij raporti.

Operatori ekonomik i ri-rekomanduar për dhënie të kontratës përmes përgjigjes ka prezantuar dëshmitë, përkatësisht paramasat e disa nga projektet e prezantuara në listë në emër të anëtarit të grupit, ku për të njëjtat AK/ Komuna Vushtrri, i ka vlerësuar si te mirëqena përkatësisht e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, “Projekte të përfunduara të punëve apo furnizimeve të ngjashme (përpunim i drurit) në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum një projekt të realizuar”.

AK, përmes dëshmisë dokumentare nuk ka përcaktuar ndonjë vlerë të caktuar për projektet.

Bashkangjitur me raport gjeni edhe disa pjese nga para masa e projekteve te prezantuara si të realizuara nga OE edhe tani i rekomanduar për dhënie.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdoj me Njoftimin e Kontratës.

Autoriteti Kontraktues me datë: 21.09.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë: 21.09.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues komform ekspertit shqyrtues sqaron se ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP, palët janë të njëjta, ankesa është e përsëritur nga OE i njëjtë, ku edhe atëherë ishte kontestuar kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, kundrejt projekteve të realizuara.

Paneli Shqyrtues përmes vendimit me nr. 399/20, të datës 27.07.2020, kishte anuluar njoftimin për dhënie të kontratës, duke obliguar AK-në që: "...gjatë ri-vlerësimit të tenderëve të vërtetoj se a janë kontratat e ngjashme apo a ka pozicione të njëjta në kontratat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë komform kërkesave të dosjes së tenderit".

Autoriteti Kontraktues/ Komuna Vushtrri përgjatë ri-vlerësimit të ofertave, përkatësisht me datën 18.08.2020, përveç OE-ve tjerë i drejtohet edhe OE tani të ri-rekomanduar për dhënie, me kërkesën kryesore, që të prezantohen dëshmitë, përkatësisht para masat e projekteve, të përshkruar në letrën standarde, kërkesën për sqarim dhe informata shtesë, ku ekspertit shqyrtues si provë ja ka bashkangjitur raporti të ekspertizës.

Paneli Shqyrtues komform ekspertit shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i ri-rekomanduar për dhënie të kontratës përmes përgjigjes ka prezantuar dëshmitë, përkatësisht paramasat e disa nga projektet e prezantuara në listë në emër të anëtarit të grupit, ku për të njëjtat AK/ Komuna Vushtrri, i ka vlerësuar si te mirëqena përkatësisht e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, “Projekte të përfunduara të punëve apo furnizimeve të ngjashme (përpunim i drurit) në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum një projekt të realizuar”. AK, përmes dëshmisë dokumentare nuk ka përcaktuar ndonjë vlerë të caktuar për projektet., ekspertit shqyrtues si provë ja ka bashkangjitur raporti të ekspertizës edhe disa pjese nga para masa e projekteve të prezantuara të realizuara nga OE edhe tani i rekomanduar për dhënie.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin vlerësimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së. Gjithashtu Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Komuna Vushtrri
- 1x1 OE -“N.N.SH. Emsa” - Suharekë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.